



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DEÇANIT

REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF DEÇANI



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA DEÇANI

Zyra Personelit

Nr: 02 / 2248

Datë:19/04/2013

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, neni 18 paragrafi 1 dhe 3, neni 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit mbi Shërbim Civil, si dhe Vendimi Nr.02/27 së Kryetarit të Komunës, Udhëheqësi i Personelit i Shërbimit Civil Komunal shpall këtë:

K O N K U R S

(Për nëpunës të karrierës)

Pozita : Zyrtar për Transportin Lokal dhe Rrugët Lokale (pranë Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike,

Koeficienti – 6

Kontrata 1 vjeçare 12 mujë pune provuese

Pozita Funksionale : Nëpunës civil i nivelit Profesional

Orari Punës ; 40 ore në Javë

Raporton : të Drejtori i drejtorisë përkatëse

Kualifikimi : Shkolla e lart ,drejtimi komunikacionit, Punëve të brendshme,

Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës :

- koordinon aktivitetin mbi transportin publik të mallrave dhe udhëtarëve me kompanitë publike dhe taksistët individual,
- cakton linjat për bartjen e udhëtarëve në trafikun urban
- jep pëlqimet për regjistrim të veprimtarisë së taksistëve sipas Rregullores së komunikacionit,
- bën shpalljen e ankandëve publike për automjetet e konfiskuara të cilat nuk tërhiqen në afat të caktuar nga pronarët,
- bashkëpunon me policinë e trafikut për lirimin e trotuareve nga automjet,
- propozon mbylljen e përkohshme të rrugëve në rast nevojë (festa etj),
- njofton sipas nevojës MTPTK-në për riparimin e shenjave, defektet në rrugët ndër-komunale
- përkujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe shesheve në sezonin e dimrit,
- ëshon leje për vendosjen e pengesave në rrugë e që janë kompetencë e komunës,
- Kryen edhe punë të tjera sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe kërkesave të shefit dhe drejtorit e tij.

Do të ftohen vetëm kandidatë të cilët hynë në listën e ngushtë:

Shërbimi civil i Komunës është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga meshkujt dhe femrat e të gjitha komuniteteve të Kosovës

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor, kandidatet e interesuar mund të marrin dhe të dorëzojnë aplikacionet e plotësuara në zyrën e pranimi – Arkivi i Komunës së Deçanit

VREJTJE:Aplikacionit duhet të bashkëngjitet dëshmia mbi kualifikimin shkollor, kopja e letërnjoftimi, certifikatën lindjes si dhe referencat dhe certifikimet tjera nëse i posedon kandidati.

Për çdo informacion mund të drejtoheni në Zyrën e personelit Nr. 4.

Udhëheqësi i Personelit

Ismet Kukleci